



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Dt. 16.04.2020**

**Për:** Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “**Interlogistic**” sh.p.k., me NIPT K21605003M

**Adresa:** Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godinë 3 katëshe, Tiranë  
&

“**Inpress**” sh.p.k me NIPT L52122014L.

**Adresa:** Ish Blloku i Magazinave të Tregtisë, Rruga Siri Kodra. **Tiranë.**

\* \* \*

**Procedura e prokurimit:** Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr.20 datë 31.05.2019 me objekt: “**Blerje Shtypshkrime**”, me fond limit prej 76.008.765,68 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa T.V.SH, të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., me procedurë “E hapur”, me mjete elektronike e cila u zhvillua më datë 10.12.2019, ora 10.00.  
*[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]*

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF -25045-05-31-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “Blerje Shtypshkrime”

**Fondi Limit:** 76.008.765,68 (shtatëdhjetë e gjashtë milion e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë presje gjashtëdhjetë e tetë) Lekë pa T.V.SH.

**Burimi i financimit:** Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme;

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 10.12.2019, ora 10.00

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 10.06.2019* [23 ]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “**Adel CO**” sh.p.k. me NIPT L22117021M me vlerë të ofertës ekonomike 68,413,674.00 (gjashtëdhjetë e tetë milion katërqind e trembëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër pikë zero) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “**ALBDESIGN PSP**” me NIPT L5181905Q me vlerë të ofertës ekonomike 69,055,820 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet) lekë pa TVSH;
3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “**Interlogistic**” sh.p.k., me NIPT K21605003M & “**Inpress**”sh.p.k me NIPT L52122014L me vlerë të ofertës ekonomike 72,779,500.00 (shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqindë e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind pikë zero) lekë pa t.v.sh.
4. Operatori Ekonomik “**Kristalina -KH**” sh.p.k me NIPT K11501002D me vlerë të ofertës ekonomike 73,689,650 (shtatëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

#### **1.Operatori ekonomik “Adel Co” sh.p.k.**

- Nuk plotëson pikën 2.2.3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi dokumentacioni ligjor i paraqitur nga OE “Adel Co” shpk., përsa i përket përmbushjes së kriterit të disponimit të “Makineri shtypi letër e vazhdueshme” nuk është në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në DST, pasi OE “Adel Co” shpk., si dokument provues për disponimin e kësaj pajisje të kërkuar në DST, ka paraqitur faturën tatimore të datës 12.04.2019, me shitës shoqërinë “Adel Print” shpk., dhe blerës shoqërinë “Adel Co” shpk., ku objekt i kësaj fature është shitblerja e një pajisje me titullimin “**Makineri për printimin e letrës traktor**”, e cila është krejt e ndryshme për nga funksionaliteti me “**Makinerinë shtypi letër e vazhdueshme**”, të kërkuar në DST.

- Nuk plotëson pikën 2.2.3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi dokumentacioni ligjor i paraqitur nga OE “Adel Co” shpk., përsa i përket përmbushjes së kriterit të disponimit të “Makineri per biosjen e letrës”, pasi deklarata doganore e cila ishte bashkëlidhur deklaratës doganore ka si objekt një pajisje me titullimin “**Makineri printimi Offset për shtypshkoronja**”, e cila është krejt e ndryshme për nga funksionaliteti me “Makineri për biosjen e letrës”, të kërkuar në DST.

#### **2. Operatori Ekonomik “ALBDESIGN PSP”**

- Nuk plotësohet pika 2.2.3 ne kriteret e veçanta ku kërkohet Makineri shtypi në rrulon Në dokumentacionin e paraqitur nga OE “Albdesign PSP” shpk., mungon dokumentacioni i nevojshëm ligjor për të vërtetuar disponimin e Makineri shtypi në rrulon. Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik është paraqitur kontrta noteriale e qirasë nr. Rep 5246, nr. Rep. 1531, datë 09.12.2019, ndërmjet shoqërisë ”Inform Albania” shpk. (Qiradhënësi) dhe ”Albdesign PSP (Qiramarrësi), me objekt të qirasë ”Makineri shtypi dixhitale në rulon, që printon të dhënat variabël, DCP500 Xeicon”, por si në

faturën tatimore të shitjes së kësaj pajisje (*e cila titullohet "Makineri printimi dixhitale me ngjyra Xeicon"*), ashtu edhe në një hulumtim të thjeshtë on-line në internet, **pajisja në fjalë nuk është Makineri shtypi në rulon**, por një makineri printimi dixhitale e të dhënave variabël

- **Nuk plotësohet pika 2.2.3** ne kriteret e veçanta ku kërkohet Makineri për mbledhjen e letrës së vazhduar të birosur. Në dokumentacionin e paraqitur nga OE "Albdesign PSP" shpk., mungon dokumentacioni i nevojshëm ligjor për të vërtetuar disponimin e Makineri për mbledhjen e letrës së vazhduar të birosur. Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik është paraqitur fatura tatimore e datës 20.09.2016, me shitës Engjëllush Serjani dhe blerës shoqëria "Albdesign PSP", ku ndër të tjera dokumentohet blerja e pajisjes / makinerisë mbledhëse fashikujsh dhe letrës kimike, e cila është e ndryshme me pajisjen / makinerinë e kërkuara në DST (*Makineri per mbledhjen e letrës së vazhduar të birosur*).

- **Nuk plotësohet pika 2.2.8** pasi Mungon Skeda Teknike e produktit "Letër Termike", ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij. Në dokumentacionin e paraqitur nga OE "Albdesign", është paraqitur vetëm dokumenti "Specifikimet e letrës termike", i cili është një deklaratë e distributorit të pretenduar "Algrafika" shpk, por nuk është një dokument që mund të zëvendësojë dokumentin "**Skedë Teknike**" të produktit të prodhuar nga prodhuesi Gold Huasheng për të cilin ka paraqitur autorizim. Pra nuk provohet lidhja e produktit të deklaruar në dokumentin "Specifikimet e letrës termike", të lëshuar nga shoqëria "Algrafika" shpk, me shoqërinë prodhuese të Letrës Termike, Gold Huasheng.

- Nuk plotësohet pika 2.2.9 dhe konkretisht për mostrat:

- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht CP.. AA, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht CP.. AL, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht RR.. AA, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht RR.. AL, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht EN.. AA, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht EB.. AA, Barcodi nuk lexohet nga Bar-reader në momentin e leximit, është i palexueshëm gjatë momentit të testimit të mostrave
- Nga mostra e paraqitur dorazi dhe konkretisht CN23 EMS, Barcodi në momentin e leximit rezulton me hapësira dhe nga 12 karaktere që duhet të ketë rezulton me 16 karaktere gjë e cila është jashtë standartit të kërkuar.

### 3. Operatori Ekonomik “Kristalina -KH” sh.p.k

- Nuk plotësohet 2.2.6 e kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi kontrata e qirasë së paraqitur nga operatori perfundon në datën 15.01.2019 dhe nuk është e vlefshëm për periudhën e tenderit e cila zgjat 90 ditë.

- **Nuk plotësohet pika 2.2.8 pasi Mungon Skeda Teknike** e produktit ”Letër Termike”, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij. Në dokumentacionin e paraqitur nga OE, është paraqitur vetëm dokumenti “Specifikimet e letrës termike”, I cili është një deklaratë e distributorit të pretenduar “Algrafika” shpk, por nuk është një dokument që mund të zëvendësojë dokumentin “**Skedë Teknike**” të produktit të prodhuar nga prodhuesi Gold Huasheng për të cilin ka paraqitur autorizim Pra nuk provohet lidhja e produktit të deklaruar në dokumentin “Specifikimet e letrës termike”, të lëshuar nga shoqëria “Algrafika” shpk, me shoqërinë prodhuese të Letrës Termike, Gold Huasheng.

- Nuk plotëson pikën 2.2.3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi dokumentacioni ligjor i paraqitur nga OE., përse i përket përbushjes së kriterit të disponimit të “Makineri parapërgatitje CTP”, pasi në dokumentin e paraqitur thuhet se janë pjesë për makineri, pjesë procesuese për lastrat, e cila është krejt e ndryshme për nga funksionaliteti me “Makineri parapërgatitje CTP”, **të kërkuar në DST.**

- Nuk plotëson pikën 2.2.3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi dokumentacioni ligjor i paraqitur nga OE, përse i përket përbushjes së kriterit të disponimit të “Makineri Shtypi në rulon dhe makineri shtypi për letrën e vazhduar pasi dokumentat që shoqërojnë kontratën me Euroform” dhe konkretisht formulari i zhdoganimit citohet se janë makineri shtypi dhe nuk cilësohet. Gjithashtu te fotot që shoqërojnë këtë kontratë për makinën, janë makineri shtypi etiketash, e cila është krejt e ndryshme për nga funksionaliteti me makinëritë të kërkuar **në DST**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “**Interlogistic**” sh.p.k., me NIPT K21605003M & “**Inpress**”sh.p.k me NIPT L52122014L me vlerë të ofertës ekonomike 72,779,500.00 (shtatëdhjetë e dy milion e shtatëqindë e shtatëdhjete e nëntë mijë e pesëqind pikë zero) lekë pa t.v.sh. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.01.2020.

Ankesa: Ka patur.

Pranë Autoritetit Kontraktor është paraqitur ankesa si më poshtë vijon:

Me datë 13.01.2020, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “**Adel Co**” sh.p.k., nr. 1551/39 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. **1551/44** prot.datë 17.01.2020.

Me datë 14.01.2020, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “**Albdesign PSP**” sh.p.k., nr. 1551/41prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. **1551/46** prot.datë 20.01.2020.

Me datë 14.01.2020, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “**Kristalina KH**” sh.p.k., nr. 1551/40 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. **1551/45** prot.datë 20.01.2020

Operatorët ekonomik “**Adel Co**” sh.p.k, “**Albdesign PSP**” sh.p.k., “**Kristalina KH**” sh.p.k., janë ankuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit të sipërpërmendur e cila me Vendimin **Nr. 133/2020 Prot, datë 09.04.2020** ka vendosur të mos pranojë ankesat e paraqitura nga Operatorët Ekonomik duke lejuar në këtë mënyrë AK Posta Shqiptare sh.a të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Laert Duraj**

